



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:078527
Datë: 26.04.2024
Numri i dokumentit: 05625950

C-II-15-0338-C-0001

Paditësja; B R nga Fshati Sh, Komuna e Gllgovcit.

Pala kundërshtare; Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga Dritan Hoxha nr.55, Lakrishte-Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykata Supreme e Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përmes gjyqtarit; Asllan Krasniqi me datën;26.04.2024 merr këtë;

A K T V E N D I M

Padia e parashtuar nga B R, konsiderohet e tërhequr për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore.

Rrethanat faktike dhe procedurale;

Dhoma e Posaçme e Gjykata Supreme e Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit me datën; 12.06.2023, ka hartuar me shkrim vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore për paditësen duke e detyruar të njëjtën që pagesën ta kryej në afatin kohor prej 15 ditëve duke llogaritur nga data e pranimit të kësaj vërejtje. Meqenëse vërejtja e hartuar nga gjykata nuk ka mundur t'i dorëzohet në adresën e dhënë si në padi, gjykata me datën 29.12.2023, vërejtjen për pagesën e takes gjyqësorë për padi e ka afishuar në tabelën e shpalljeve të kësaj gjykate duke e ftuar paditësen që brenda afatit prej 15 ditëve ta bëjë pagesën e taksës gjyqësore për padi. Në shkresat e lëndës rezulton se paditësja edhe përkundër faktit të vërejtja për pagesën e taksës ka qëndruar në tabelën e shpalljeve deri me datën 12.01.2024, në shkresat e lëndës nuk ka dëshmi se pagesa është kryer.

Arsyetimi ligjor;

Dhoma e Posaçme e Gjykata Supreme e Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit duke iu referuar shkresave të lëndës ka konstatuar se paditësja edhe përkundër faktit se vërejtja për pagesën e taksës gjyqësorë për padi është afishuar në tabelën e shpalljeve të kësaj gjykate nga data 29.12.2023, e deri me datën 12.01.2024, nuk e ka paguar taksën gjyqësore në afatin kohor prej 15 ditëve.

Andaj gjykata duke iu referuar dispozitës së nenit 253 paragrafi 5 të LPK-së ka vendosur ashtu si është përcaktuar në dispozitivin e këtij aktvendimi.

Këshilla Juridike;

Ndaj këtij aktvendimi parashtruesi i ankesës mund të ushtrohet ankesë me shkrim duke iu drejtuar Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës në afatin kohor prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve duke llogaritur nga data e pranimin të këtij aktvendimi.

Gjyqtari;
Asllan Krasniqi